



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit

P-049

Prishtinë, më 14 dhjetor 2015, në orën 09:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 14 DHJETOR 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Slobodan Petroviq dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri dhe Slavko Simiq.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi, Driton Lajçi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit se qëllimi i mbajtjes së kësaj mbledhjeje të Kryesisë është konsultimi lidhur me mbledhjen plenare që është caktuar, të mbahet për sot, më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00.

Pastaj, kryetari e deklaroi përfundimin e Kryesisë së Kuvendit për largimin e deputetëve nga seanca plenare mbajtur, më 30 nëntor 2015, si vijon:

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca, znj. Shqipe Pantina, znj. Besa Baftija, z. Salih Salihu, z. Mytaher Haskuka, z. Besnik Bislimi, z. Visar Ymeri, znj. Aida Dërguti, z. Rexhep Selimi, z. Ismajl Kurteshi, z. Ramush Haradinaj, z. Pal Lekaj, znj. Teuta Haxhiu, z. Daut Haradinaj, z. Bali Muharemi, znj. Time Kadrijaj, z. Rustem Berisha, z. Lahi Ibrahimaj, z. Fatmir Limaj, z. Enver Hoti, z. Haxhi Shala, z. Zafir Berisha dhe znj. Valdete Bajrami për shkak se me sjellje dhe veprimet e tyre pamundësuan zhvillimin e punimeve të seancës plenare, largohen nga pjesëmarrja në seancën plenare, më 30 nëntor 2015.

Në vazhdim, kryetari i Kuvendit e hapi diskutimin lidhur me përgatitjet për seancën plenare të caktuar për sot, më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00.

Lidhur me përgatitjet dhe mbarëvajtjen e seancave plenare, si dhe krijimin e kushteve të sigurisë për deputetët e Kuvendit, diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti dhe Aida Dërguti, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Adem Grabovci, kryetar i GP të PDK-së dhe Ismet Beqiri, kryetar i GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në fund, kryetari tha se Kryesia e Kuvendit e as ai asnjëherë nuk kanë dashur t'i largojnë nga seanca plenare deputetët e opozitës, por ata me sjelljet e tyre të dhunshme dhe moslejimin e mbajtjes së seancave plenare e kanë sjellë vetëpërkashtimin. Ne kemi nevojë për një komunikim njerëzor dhe politik, që të bashkëbisedojmë dhe ta ndërtojmë komunikimin me kolegët e opozitës, sepse nuk jemi të interesuar që opozita të dalë jashtë seancave plenare, por u bëjmë thirrje që të kthehen në mbarëvajtjen e punimeve të seancave plenare.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 10:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale